



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 161-2/ 2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, duke vendosur përkritazi me kërkesën për rishqyrtim të PDK-së, të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, me Anr.161/2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I** **MIRATOHET** e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, PDK-së, e paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, me Anr.161/2019, të datës 04.10.2019.

**II** **Ndryshohet vendimi i PZAP-it** Anr. 161/2019 i datës 04.10.2019, ashtu që **HUDHET** palejuar ankesa, Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur me 01.10.2019 si çështje e gjykuar, me vendimin Anr.153/2019 i datës 04.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP, me datë 01.10.2019, ka pranuar ankesën Anr. 153/2010 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të dyja me seli në Prishtinë, si dhe ankesën e dytë, A.nr. 161/2019, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) të dyja me seli në Prishtinë. Që të dy ankesat janë të paraqitura kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për vendosjen se posterit të kandidatit për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Novitet Nezaj, mbi rrugën publike në fshatin Gjonaj në Hasë, Komuna e Prizrenit.

Me datës 05.10.2019 subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka parashtruar kërkesë për rishikimin e vendimit të PZAP-it, A.nr. 161/2 të datës 02.10.2019, me arsyetim se panele ka vendosur dy herë për të njëjtën çështje dhe shkelje të njëjtën. Me ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ndaj PDK-së, vendimin A.nr. 161/2019, PDK-së i është shqiptuar gjobën prej 5100 euro. Kurse me vendimin A.nr. 153/2019, sipas ankesës së LDK-së dhe KDI-së, PDK i është shqiptuar dënimi prej 2,900.00 euro.

Neni 118.4 i LZP-së parasheh që : *Mund të apelohe vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuara.*

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së apelit gjeti se:

#### **Apeli është i palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, gjeti se e njëjta është e bazuar kjo për faktin se, me vendimin e PZAP-it, A.nr. 161/2 të datës 02.10.2019, panele ka vendosur dy herë për të njëjtën çështje dhe shkelje të njëjtën. Me ankesën e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ndaj PDK-së, vendimin A.nr. 161/2019, PDK-së i është shqiptuar gjobën prej 5100 euro. Kurse me vendimin A.nr. 153/2019, sipas ankesës së LDK-së dhe KDI-së, PDK i është shqiptuar dënimi prej 2,900.00 euro.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se të dy vendimet kanë të bëjnë me njëjtësinë subjektive ,objektive dhe me gjendje të njëjtë faktike. Ankesa parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ndaj PDK-së, vendimin A.nr. 161/2019, PDK, është çështje e gjykuar “res iudicata”.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e në pajtim me dispozitat e nenit 11.5 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 161-2/2019 më datën 06.10.2019

**Kryesuese e Panelit  
Gyltene Sylejmani**



***Këshillë Juridike: Kunder këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa conform nenit 118.4***